

RENOFIX 20

LLAÇI THEMELOR NGJA ÇIMENTO - REZISTUES NDAJ UJIT
PËR MURE ME LAGËSHTI

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik!

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT

Llaç themelor për suvatim të mureve të brendshëm dhe të jashtëm (fasadave), si llaç për cokle, për bazamente të mbingarkuara nga lagështia dhe suvatim në hapësira të ftohta dhe me lagështi. Përdoret mbi të gjitha llojet e bazamentit normal, mbi beton të vrazhdë, si llaç për suvatim të shahtave dhe llaç për mure të bodrumeve.

PËRMBAJTJA:

- Çimento
- Rërë karbonati me granula nga 0-1.2 mm
- Shtesa të cilat e përmirësojnë cilësinë

VEÇORITË:

- Rezistues ndaj ujit (nuk e lëshon ujin)
- Kualitet i lartë i përpunimit
- Rezistueshmëri të përhershme ndaj ujit

PËRGATITJA BAZËS:

Bazamenti duhet të jetë i sheshtë (i rrafshuar), i thatë, i pastruar nga pluhuri, mbeturinat dhe vajrat. Testimet e bazamentit bëhen sipas EN normave. Udhëzimet e përpunimit janë të vlefshme për muret që janë të ndërtuar me norma të caktuara dhe që nënkuptojnë mure me fuga dhe çarje të mbyllura. Nëse bazamenti ka fuga të hapura apo çarje, të njejtat paraprakisht duhet të mbyllën (armohen) me Renofix 5 ngjitëse ndërtimi dhe rrjetë armuese. Sipërfaqet e absorbueshme paraprakisht duhet të lagen me ujë.

PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes Renofix 20 zbrazet në 8-8.5 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser për 2 minuta. Nëse përgatitet me makinë, atëherë llaçi përgatitet me makinën e llaçit Skure-Tech S4.

PËRPUNIMI DHE KUSHTET E PËRPUNIMIT:

Gjatë përpunimit me dorë të llaçit, i njëjti vendoset me mistri dhe rrafshohet. Gjatë përpunimit me makinë, materiali vendoset (shpricohet) me makinën e llaçit Skure-Tech S4. Pas vendosjes, materiali sheshohet me sheshues (rrafshues) alumini. Trashësia minimale e shtresës është 10 mm, por nëse është nevojë mund të vendosen disa shtresa të llaçit. Në raste të tilla duhet që shtresa e vendosur paraprakisht të thahet 1-2 orë. Mbi sipërfaqet e lëmuara të betonit detyrimisht përdoret Renofix 5 ngjitës ndërtimi si llaç lidhës (beton kontakt) dhe më pas vendoset shtresë e Renofix 20 (e lagur në të lagur). Materiali shfrytëzohet brenda 2 orëve. Gjatë kohës së ngurtësimit (lidhjes), duhet të sigurohen kushte të mira për tharje dhe ngurtësim. **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzjerja me materiale tjera.



VËRREJTJE:

Përmban çimento. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla, sytë dhe lëkura të lahen me ujë të pastër.

PAKETIMI:

Në thasë letre nga 40kg. që janë të mbrojtura nga lagështia.




DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 6 muaj.

RENOFIX 20

Të dhënat teknike:	
Numri i prodhimit:	5319990620118
Shifra e prodhimit:	1020
Thasë në paletë:	30
Granulacioni:	1,2 mm
Sasia e nevojshme e ujit:	8-9 l/thes
Trashësia minimale e shtresës:	10 mm
Harxhimi:	Për trashësi prej 10 mm, 15 kg/m ²
Shënim:	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10):	ca 1500 kg/m ³
Përcjellshmëria e nxehtësisë (1745:2002):	ca 0.54 W/mK
Vlera – pH:	ca 12
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):	ca 6.0 N/mm ²
Elasticiteti pas 28 ditëve (EN 1015-11):	ca 2.8 N/mm ²
Reagimi gjatë djegjes:	A 1
MG (EN 998-1):	GP CSIII WO 2

Udhëzime të përgjithshme: Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në disponimin tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: www.renova.com.mk si ose mund t'i kërkontë në sektorin e shitjes.



RENOVA PUTZ | www.renova.com.mk

RENOVA Xhepçisht , Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | info@renova.com.mk
 RENOVA Gureza, Ferizaj, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | renova_ferizaj@hotmail.com
 RENOVA Vore, Tirana, Albanija | Tel.: 00355 48 301 909 | Fax: 00355 48 301 908 | renova.tirana@hotmail.com